



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 35
Prishtinë, më 26.4.2022, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajraliu, Eman Rrahmani, Yllza Hoti, Hajdar Beqa, Albana Bytyçi, Halil Thaçi, Bekim Arifi dhe Mirlinda Tishukaj-Sadiku.

Munguan: Adem Hoxha dhe Rashit Qalaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Antigona Ibraj dhe Viona Bunjaku.

Pjesëmarrës të tjerë: Xhemajl Halili, nga Kuvendi i Kosovës, Violeta Smajlaj nga ZKA dhe Evetar Zeqiri, nga OSBE.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.3.2022;
3. Diskutim rreth procedurave të iniciuara nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për auditimin e raporteve vjetore financiare dhe raportet e deklaramit financiar të fushatës, së subjekteve politike, për vitin 2021 dhe auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZKA-së për vitet 2021, 2022 dhe 2023;
4. Shqyrtimi i pyetësorëve të pranuar nga OB-të, në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Mbledhjen e kryesoi Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit, e hodhi në votim rendin e ditës, i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.3.2022

Kryetarja e hodhi në votim procesverbalin, e mbledhjes së mbajtur më 29.3.2022, i cili u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim rreth procedurave të iniciuara nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për auditimin e raporteve vjetore financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës, së subjekteve politike, për vitin 2021 dhe auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZKA-së për vitet 2021, 2022 dhe 2023

Kryetarja Hykmete Bajrami, hapi mbledhjen duke potencuar se sot kemi prezent edhe drejtorin e Drejtorisë së Prokurimit, z.Xhemajl Halili dhe do të diskutojmë rreth kësaj çështje, pra rreth procedurave ku ka dështuar që disa herë radhazi tenderi për përzgjedhjen e një kompanie, për të bërë auditimin e pasqyrave vjetore financiare të subjekteve politike, por gjithashtu e kemi edhe çështjen e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Komisioni duhet të marrë një vendim rreth kësaj procedure. I jap fjalën drejtorit, për të na treguar se çfarë ka ndodhur deri më tani dhe nëse keni ndonjë propozim apo ndonjë praktikë sesi është vepruar në raste të tilla, nëse ka pasur më herët, pra t'i ndani me ne.

Drejtori i Prokurimit, z.Xhemajl Halili, tha se Drejtoria e Prokurimit edhe në vitet e kaluara ka pasur telashe për këtë proces. Ne jemi munduar të identifikojmë pengesat e vitit të kaluar dhe kemi ardhur në përfundim se operatorët ekonomikë nuk kanë qenë të kënaqur me vlerën e parashikuar të aktivitetit të prokurimit, por kjo mendoj se është një rrezik, sepse nëse vazhdimisht operatorët ekonomikë kanë vlera të tjera, ata na vënë para një akti që ne duhet t'i përshtatim kërkesat tona me ata. Ndërsa, këtë vit e kemi proceduar dy herë, por ka dështuar tenderi, sepse nuk kemi pasur asnjë ofertë. Në qoftë se problemi është tek vlera, operatorët ekonomikë, nëse mendojnë për këtë, ne nuk kemi ndonjë reagim nga ana e tyre, sepse herëve të tjera kemi pasur shkresa kur operatorët ekonomikë kanë arsyetuar, sikurse ka ndodhur për auditimit e subjekteve politike, ku janë arsyetuar me pretekstin se janë mbajtur dy palë zgjedhje dhe nuk munden ta përfundojnë. Prandaj, në këtë vit nuk kemi asnjë reagim, asnjë arsye, por që mund të ndodhë që janë të pakënaqur me buxhetin. Problem tek auditimi i subjekteve politike për operatorët ekonomikë është se ligji kërkon 10 auditorë dhe ata ose duhet të bëjnë një marrëveshje interne që ai operator ekonomik që konkurren, të bëjë një parakontratë, por që zakonisht ka një ofertues ose dy ofertues dhe mendoj se ligji ka paraparë një kërkesë e cila është vështirë e zbatueshme në praktikë.

Kryetarja Hykmete Bajrami pyeti drejtorin: Sa është buxheti në dispozicion për të dyja aktivitetet?

Drejtori z.Halili, tha se për auditimin e subjekteve politike, buxheti është 30 mijë euro dhe është i paraparë vetëm për vitin 2021, ndërsa tek auditimi i pasqyrave vjetore financiare për ZKA-në është 10 mijë euro, por që ne kemi menduar të zhvillojmë procedurë të përbashkët, që i bie të jetë

kontratë afatgjate për 3 vite, që i bie diku rreth 3,333 euro për një vit. Nëse marrim parasysh edhe lëvizjet në treg, mund të jetë që çmimi të mos jetë i mjaftueshëm.

Kryetarja Hykmete Bajrami, hapi diskutimin për deputetët, dhe gjithashtu propozoi që Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere t'i shkruajë një letër që auditimi t'i kalojë Zyrës Kombëtare, pasi që Komisioni është duke punuar rreth Ligjit për financimin e subjekteve politike, dhe nëse pajtoheni, ne mund t'i drejtohem me një letër apo edhe ju që jeni vetë pjesë e Komisionit, sepse siç e di, ka pasur një dëgjim publik rreth plotësim-ndryshimit të ligjit, por nëse ju jeni anëtarë mund të përcillni këtë informatë dhe të adresohet auditimi te ZKA. Atëherë, nëse edhe ju keni ndonjë propozim, sesi do të procedojmë më tutje. Propozoj që të bëhet një hulumtim në vendet e rajonit dhe të shohim sesi është e rregulluar. Besoj që Zyra e OSBE mund të na ndihmojë, por edhe Zyra e Hulumtimit, brenda Kuvendit.

Eman Rrahmani, nuk po shoh se kemi shumë mundësi edhe pasi që nuk ka ankesa nga ana e tyre dhe po besoj që duhet të vazhdojmë të përsërisim procedurën e prokurimit, sepse nuk mund të paragjykojmë për vlerën, pasi që nuk kemi ndonjë ankesë dhe nuk mund të paragjykojmë. Gjithashtu, nuk jemi pjesë e grupit punues në Komisionin për Buxhet, por pajtohem që ZKA do të duhej të bënte auditimin e raporteve financiare të subjekteve politike dhe pastaj na mbetet problem raporti i auditimit i ZKA-së për pasqyrat financiare, sepse ZKA nuk mund të auditojë veten. Andaj, tha se pajtohem se duhet të bëhet një hulumtim sesi është e rregulluar kjo çështje në vendet e rajonit dhe pastaj në mbledhjen e ardhshme t'i diskutojmë.

Hajdar Beqa, tha se sa i përket auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike, ky problem mund të jetë edhe prej buxhetit, por që edhe më herët ka pasur probleme të tilla dhe ky problem realisht ka qenë edhe te KQZ-ja. Mendoj se kjo varet nga vullneti politik se a duhet të shkojë kjo përgjegjësi te KQZ apo tek ZKA-së. Mendoj se te ZKA është më mirë, por që sipas njohurive të mia edhe vendet e rajonit e kanë të rregulluar që kjo çështje është përgjegjësi e KQZ-së. Andaj, mendoj se duhet të marrim disa vende për të parë praktikën e tyre, por që neve na duhet të ecim përpara, me këtë procedurë.

Nënkryetarja e parë Arta Bajraliu, tha se pajtohet me anëtarët e komisionit, që procedura të vazhdohet ngjashëm sikur herëve të kaluara dhe hulumtimi të bëhet nga Drejtoria e Hulumtimeve. Por, mendoj se problemi do të jetë nëse shkojmë sipas SGA, sepse partitë politike kanë edhe donacione private dhe të hyrat nga bashkëpagesat dhe kjo bie ndesh me autorizimet që ka me Ligjin e auditorit të përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Përfundim

KMPF-ja vendosi që procedurat tenderuese për auditimin e raporteve vjetore financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës, së subjekteve politike, për vitin 2021 dhe auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZKA-së për vitet 2021, 2022 dhe 2023, të përsëritet, dhe gjithashtu Komisioni u pajtua që Drejtoria për Hulumtime, brenda Kuvendit, të bëjë një hulumtim, sa i përket auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike në vendet e rajonit. Po ashtu, u pajtuan që edhe Zyra e OSBE-së të bëjë një hulumtim sesi është e rregulluar në vendet e rajonit rreth auditimit të raporteve të auditimit të subjekteve politike.

4. Shqyrtimi i pyetësorëve të pranuar nga OB-të, në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike

Kryetarja Hykmete Bajrami, tha se tani jemi në proces, ku edhe kemi marrë përgjigje nga disa institucione rreth pyetësorëve për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike, ku nga 21 institucione, 12 prej tyre kanë kthyer përgjigje dhe pothuajse kemi parë edhe sfidat nga analiza që e kemi marrë. Unë do të propozoja që administrata t’iu dërgojë edhe një e-mail, si rikujtim, sepse ka institucione që munden ende të dërgojnë përgjigje. Gjithashtu e pamë se ka kolizion në mes të ligjeve dhe andaj mund të diskutojmë për vizitat e mundshme në disa prej institucioneve. Andaj, i jap fjalën kryetares së grupit punues, për të na treguar më shumë rreth procesit.

Nënkryetarja e parë Arta Bajraliu, tha se si grup punues, ne kemi zhvilluar një vizitë deri më tani në Njësinë Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave, gjithashtu edhe kemi mbajtur një punëtori me “Democracy Plus”, ku kemi diskutuar se cilave institucione duhet t’iu dërgohen pyetësorët. Unë mendoj se duhet të realizojmë vizita në institucione që nuk na kanë kthyer përgjigje me pyetësorët e plotësuar. Ashtu siç edhe ju e shihni të arsyeshme, ne mund t’iu dërgojmë edhe një rikujtim atyre që nuk kanë kthyer përgjigje.

Kryetarja Hykmete Bajrami, tha se sot, pas mbledhjes, të dërgohet edhe një e-mail në institucione që nuk kanë kthyer përgjigje dhe t’u caktohet një afat i dytë, deri më 6 maj. Në mbledhjen e radhës, ne mund të vendosim se cilat institucione të vizitohen, pasi që mund të marrim edhe përgjigje të tjera. Vlen të përmendet se në Thesar shihet një funksionim i dobët i auditimit të brendshëm, mandej pothuajse të gjitha institucionet kanë probleme me buxhetin për trajnim.

Përfundim

KMPF-ja vendosi që institucionet të cilat nuk i kanë dorëzuar pyetësorët monitorues, t’iu jepet afat shtesë, që këtë ta bëjmë deri më datë 6.5.2022.

5. Të ndryshme

Kryetarja Hykmete Bajrami, tha se për mbledhjen e radhës së komisionit të caktohet një institucion për të vizituar lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga raportet e auditimit.

Përfundim

KMPF-ja vendosi që ndërmarrja publike Telekom i Kosovës, të vizitohet më datë 4.5.2022, për të shikuar se sa janë zbatuar rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit të ZKA-së.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hykmete Bajrami,
Kryetare e Komisionit